



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
“TIRANA DC” SH.A
DREJTORIA E PROKURIMIT

Drejtuar: Operatorit ekonomik “3i-solutions” sh.p.k

Adresa: Rruga “Stavro Vinjau”, Pall 2, H.9, Zona Kadastrale Nr.8160, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 30 si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar) kreu IV, Neni 33.

Referenca e procedures: REF- 86738-02-11-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës:Qëllimi i kontratës është: “Informatizimi i proceseve operacionale te shoqërisë Tirana DC sha, implementimi i infrastrukturës mbështetëse si dhe mirëmbajtja e tyre”

Fondi limit: 73.796.533 (shtatëdhjetë e tremilion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:Periodha për implementimin e sistemit më të gjithë komponentët përbërës do të jetë 2 (dy) muaj nisur nga data e lidhjes së kontratës. Periodha e mirëmbajtjes do të jetë 48 (dyzet e tetë) muaj nga data e lidhjes se kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 08.03.2021

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini Nr. 21, datë 15 Shkurt 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Bashkimi i operatorëve ekonomik “Infosoft Systems” shpk & “ikubINFO” shpk**
NUIS J61820021C & L11712002T

Vlera totale e ofertës pa TVSH = **62.175.812** (gjashtëdhjetë e dymilion e njëqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e tetëqind e dymbëdhjetë) lekë.

1. Operatori ekonomik “3i-solutions” shpk

NUIS L52305007S

Vlera totale e ofertës pa TVSH = **70.106.873** (shtatëdhjetë milion e njëqinde gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Infosoft Systems” shpk & “ikubINFO” shpk NUIS J61820021C & L11712002T

I. *Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 9 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:*

Operatori ekonomik duhet të disponojë ekspertë të çertifikuar të cilët do të angazhohen në implementimin e projektit me kualifikimet e mëposhtme:

Të paktën 1 (një) person me mbi 10 vite eksperiencë, i çertifikuar për menaxhimin e projekteve dhe proceset Agile (Çertifikimi duhet të jetë aktiv, i verifikueshëm në listën e publikuar nga PMI ose ekuivalente).

Në plotësim të kësaj pike bashkimi i Operatorëve “ ikubINFO” shpk & “Infosoft Systems” shpk ka paraqitur si person të çertifikuar për menaxhimin e projekteve PMP dhe proceset Agile punonjësen Bora Bimbari.

Për këtë punonjëse është paraqitur çertifikata PMP nga PMI – Projekt Management Professional dhe çertifikata Professional Scrum Master i çertifikuar nga Scrum.org.

Pas verifikimit të kryer nga komisioni i vlerësimit të ofertave, vërejmë se çertifikata Professional Scrum Master çertifikatë e lëshuar nga Scrum.org nuk paraqet elementët e ekuivalencës me çertifikatën e kërkuara për Menaxhimin e Projekteve dhe Proceseve Agile nga PMI.

Çertifikata e paraqitur në fakt, dëshmon për fitimin e njohurive bazike (Demonstrated a Fundamental Level of Scrum Mastery) në një nga drejtimet specifike ku mund të degëzohen njohuritë mbi menaxhimin e projekteve sipas framework-ut dinamik Agile. Çertifikimi Agile Practitioner nga PMI, përfshin fitimin e njohurive duke përfshirë disa metodologji specifike sikundër janë Scrum, Kanban, Lean apo XP dhe TDD. Pra çertifikimi “Certified Scrum Master” siguron fitimin e njohurive vetëm për një pjesë të kufizuar të grupit të metodologjive që mbulohen nga frameworku Agile.

Për sa më lart, çertifikatë ekuivalente, do të quhej një çertifikatë që dëshmon fitimin e njohurive mbi menaxhimin e projekteve dhe proceseve me frameworkun Agile, e lëshuar kjo nga autoritete çertifikuese si PMI apo ekuivalente të saj. Znj.Bora Bimbari disponon çertifikatën PMP të lëshur nga autoriteti PMI, e cila është e verifikueshme në bazë të numrit përkatës, ndërsa në lidhje me proceset Agile zotëron një nivel bazik të njohurive, kryesisht të fokusuara në përmirësimin e proceseve, pjesë përbërëse të një produkti apo rezultati, por jo ekspertizë të thellë në menaxhimin e fazave të ndryshme të një mega-projekti kompleks.

Gjithashtu vlen të theksohet se bazuar në standartet ndërkombëtare, menaxherët e projekteve (senior lever) duhet të kenë një experiencë rreth 10 vjeçare, kohë e nevojshme kjo për të zhvilluar, drejtuar dhe dorëzuar projekte komplekse dhe masive sipas rezultateve të pritshme. Detyrat dhe përgjegjësitë në këtë rast janë shumëplanëshe dhe të ndërvarura me njëra-tjetrën. Është detyra e menaxherit të projektit në rastin konkret, Znj.Bora Bimbari, e cila do të

identifikojë burimet e nevojshme (të brendshme dhe/ose të jashtme) njerëzore dhe financiare, të monitorojë fazat dhe progresin e projektit, duke kapërcyer pengesa apo situata bllokuese pa vonesë, të ndjekë me vëmendje trendet bashkëkohore të teknologjisë, duke parë mundësinë e implementimit apo përshtatjes në sistemet aplikative të Autoritetit Kontraktor.

Gjithashtu, menaxheri i projektit zhvillon dhe egzekuton një strategji komunikimi efçente me të gjitha nivelet e ekipit të përfshirë në projekt, duke alokuar detyra dhe përgjegjësi stafit në bazë të experiencës dhe aftësive individuale, për të arritur objektivat finale me sukses. Nga verifikimi i CV-së të Znj. Bora Bimbari konstatohet se ka patur eksperiencë të shumta si zhvillues softwari apo drejtues dedaktik por, nuk ka eksperiencën e mjaftueshme të kërkuar 10 vjeçare të fokusuar plotësisht në drejtimin dhe menaxhimin e projekteve komplekse, ku të prevalonin aftësitë menaxheriale të personit, pasi do të luajë një rol kyç në mbarëvajtjen në tërësi të projektit.

Pra sa më sipër nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur bashkimi i operatorëve ekonomik “ ikubINFO” shpk & “Infosoft Systems” shpk nuk plotëson pikën 9 të “Kritereve të veçanta për kualifikim”, “Kapaciteti Teknik” ku specifikisht është kërkuar 1 (një) person me mbi 10 vite eksperiencë, i certifikuar për menaxhimin e projekteve dhe proceset Agile.

Është detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur nga secili prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur **të gjitha kriteret** që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

II. Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 13 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:

-Operatori ekonomik duhet të disponojë ekspertë të certifikuar të cilët do të angazhohen në implementimin e projektit me kualifikimet e mëposhtme:

Minimalisht 1 (një) informaticien të certifikuar si Analist Biznesi Softëare në proceset Agile.

Në plotësim të Këtij kriteri bashkimi i operatorëve ekonomik “ ikubINFO” shpk & “Infosoft Systems” shpk ka paraqitur si person të certifikuar Analist Biznesi Software Znj. Ornela Gugushka e certifikuar Software Business Analyst, lëshuar nga Brainbench.

Pasi autoriteti e shqyrtoi këtë certifikim kundrejt kërkesës së shprehur në kriterin e kualifikimit, vërehet qartë se certifikimi i paraqitur për Znj.Ornela Gugushka, nuk përmbush kriterin cilësor specifik në Proceset Agile. Certifikata e paraqitur është e nivelit bazë përse i përket proceseve të biznesit në tërësi, por nuk dëshmon që mbajtësi i kësaj certifikatë zotëron njohuri të provuara për të kryer analizën e proceseve të një software të implementuar/prodhuar sipas frameçorkut Agile. Znj. Ornela Gugushka nuk zotëron certifikatë tjetër që të dëshmoje

njohuri mbi frameworkun Agile.

Gjithashtu referuar CV së paraqitur për Znj.Ornela Gugushka konstatohet se nuk ka experiencë të mirëfilltë në këtë drejtim. Aftësitë kryesore shtrihen më së shumti në drejtim të ndërtimit të sistemeve dhe programimit, dhe nuk janë paraqitur informacione konkrete për ndonjë projekt të mëparshëm, në të cilin ky person të ketë marrë përsipër këtë rol (fazën e analizës) dhe të ketë konkluduar me sukses.

Pra sa më sipër nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur bashkimi i operatorëve ekonomik “ikub INFO” shpk & “Infosoft Systems” shpk nuk plotëson pikën 13 të “Kritereve të veçanta për kualifikim”, Kapaciteti Teknik ku specifikisht është kërkuar 1 (një) informaticien të çertifikuuar si Analist Biznesi Software.

Është detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur nga secili prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”

III. Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 3.3.1 përcaktohet se operatorët ekonomik pjesëmarrës për tu kualifikuar për këtë procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kriterin sa më poshtë:

3.3.1 Dëshmi të furnizimeve/shërbime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 29.518.613 (njëzet e nëntë milion e pesëqind e tetëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH të realizuara gjatë tri viteve të fundit (përlogaritur nga data e zhvillimit të tenderit). Për të vërtetuar këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kur furnizimi i së njëjtës natyre është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate.
- Kur furnizimi i së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik ”ikubINFO” shpk si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik ”ikubINFO”shpk & “Infosoft Systems”shpk në përqindje bashkëpunimi 69.61 % ka paraqitur kontratat sa më poshtë:

1. Kontratë me Agjencinë e Prokurimit publik Nr.8812 prot, datë 14.07.2016 me objekt “Ri-inxhinierim dhe shtim i funksionaliteteve, shërbimeve në sistemin e prokurimit elektronik mbështetur në një teknologji dhe infrastrukturë të re” me afat të

implementimit të projektit 9 muaj dhe afat të mirëmbajtjes 2 vjet nga data e mbarimit të implementimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit në tërësi konstatohet që kontrata ka të përfshirë në zërat e preventivit zhvillim dhe implementim infrastrukturë me një afat zbatimi 9 (nëntë) muaj dhe gjithashtu mirëmbajtjen e sistemit të implementuar për një afat 2 (dy) vjeçar. Në kontratën e paraqitur si dhe vërtetimet e realizimit të lëshuara nga Autoriteti Kontraktor konstatohet që procesi i implementimit të projektit kryer nga "ikubINFO" shpk për këtë kontratë ka përfunduar në datë 07.04.2017 dhe është qartësisht e dukshme që është realizuar jashtë afatit 3-vjeçar të parashikuar nga neni 28 pika 3 e Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Brenda afatit 3-vjeçar nga data e zhvillimit të procedurës është kryer vetëm mirëmbajtja e sistemit si një ndër shërbimet e parashikuara në preventivin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor. Sa më sipër konkludohet se operatori ekonomik nëpërmjet kësaj kontrate nuk ka mundur të provojë eksperiencë të mëparshme të ngjashme brenda 3 viteve të fundit referuar tërësisë së shërbimit që ka marrë përsipër të realizojë në kontratën e bashkëpunimit ku kryesisht ka marrë përsipër të kryejë zhvillim, implementim dhe konfigurim të sistemeve dhe moduleve, liçenca, trajnime etj. Kontrata është e një natyre specifike dhe kërkon nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës që të kenë kryer eksperiencë të ngjashme me të njëjtën tipologji brenda afatit të përcaktuar. Bëjmë me dije se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme ose jo nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës apo emërtimin e objektit por duhet parë në lidhje me zërat konkretë të punimeve të realizuara nga operatori ekonomik. Kontrata e cila përmban vetëm mirëmbajtjen e sistemit nuk mund të konsiderohet e ngjashme nga ana e Autoritetit Kontraktor.

2. Kontratë me AKSHIN Nr.6587 prot, datë 21.11.2018 me objekt "Vërtetim elektronik i gjendjes gjyqësore" ku operatori ekonomik "ikubINFO" shpk ka marrë përsipër të realizojë 70.06 % të kontratës dhe konkretisht zërat "përmirësim i sistemit", "Integrim i sistemit me sisteme të tjera" dhe "Mirëmbajtje e sistemit".

Të dy këto zëra "përmirësim i sistemit" dhe "Integrim i sistemit me sisteme të tjera" paraqesin shërbime të cilat kryhen mbi sisteme softëerike ekzistuese, dhe në objektin e kontratës së dorëzuar në këtë procedurë prokurimi, nuk parashikohet zhvillimi i një sistemi softëerik të ngjashëm me objektin e prokurimit. Operatori ekonomik "ikubINFO" shpk si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik për të përmbushur kërkesën për kontratë me objekt të ngjashëm me objektin e prokurimit, në fakt ka paraqitur një kontratë ku dëshmohet se janë kryer shërbime të përmirësimit dhe integritit të një sistemi softwerik me sisteme të tjera. Qartazi kuptohet që zhvillimi/ndërtimi i sistemit softwerik bazë, mbi të cilin kompania "ikubINFO" shpk, ka kryer shërbimet objekt kontrate, është zhvilluar apo furnizuar jashtë objektit të kontratës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve për të plotësuar kriterin kualifikues 3.3.1, Kapaciteti Teknik. Vlen për të theksuar që përmirësimet ose integrimet në një sistem ekzistues nuk kanë të njëjtën ngjashmëri me objektin e prokurimit, i cili kërkon ndërtimin e një sistemi që nuk disponohet aktualisht nga Autoriteti Kontraktor, pra zhvillimi i një sistemi softwerik "nga fillimi". Një sistem ekzistues e ka të përfunduar arkitekturën logjike dhe fizike të sistemit si në nivel software po ashtu edhe infrastrukturë (hardware), qartësimin dhe dakordësimin e kërkesave të biznesit, të gjitha komponentet e sistemit si ndërtimi i bazës së të dhënave, shtresëzimin e aplikacionit, menaxhimi i përdoruesve, rolet dhe përgjegjësitë e tyre në sistem, si dhe funksionalitete të ndryshme që eventualisht janë zhvilluar në sistem. Shërbimet e përmirësimit apo integritit të një sistemi ekzistues, konsiston kryesisht në modifikime që kryhen mbi bazat

e këtij sistemi. Natyra e shërbimeve dhe ekspertizës së kërkuar në këtë objekt prokurimi, i cili specifikisht kërkon ndërtimin e disa sistemeve të reja, që do duhet të zhvillohen nga asgjë ekzistuese, është e ndryshme nga objekti i kontratës së dorëzuar ku konsiston në shërbime që kryhen mbi një sistem ekzistues. Pra sa më sipër edhe kjo kontratë nuk mund të konsiderohet e ngjashme referuar zërave që ka marrë përsipër operatori ekonomik në kontratën e bashkëpunimit pasi i vetmi zë i realizuar dhe i ngjashëm me kontratën që prokurohet është mirëmbajtja e sistemit. Kontrata e cila përmban vetëm mirëmbajtjen e sistemit nuk mund të konsiderohet e ngjashme nga ana e Autoritetit Kontraktor.

2. Kontratë me USAID me objekt “Zhvillimi i software për një sistem deklarimi elektronik të pasurive dhe konfliktit të interesave”.

Autoriteti Kontraktor pas verifikimit të dokumentacionit konstaton se operatori ekonomik në plotësim të dokumentacionit provues për kontrata të lidhura me subjekte private ka paraqitur faturat tatimore të shitjes. Faturat e paraqitura janë të papërkthya në gjuhën shqipe sikundër përcaktohet për këtë procedurë në dokumentat e tenderit.

Në shtojcën nr. 8, “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon: “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të liçensuar dhe të noterizuar në gjuhën shqipe”.

Në nenin 14 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht: “Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”. Ndërsa në dokumentat e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika 4.6 është përcaktuar shprehimisht: “...4.6 Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip x Anglisht Tjetër _____...”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, konstatojmë se, në përmbushje të kriterëve të vendosura nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit, operatori ekonomik ka paraqitur faturat tatimore të cilat rezultojnë të jenë, në gjuhë të huaj dhe të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, në kundërshtim me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit. Në seksionin IV të dokumentave të tenderit, si dhe në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përkufizuar qartë që gjuha e përdorur është gjuha shqipe dhe rrjedhimisht çdo dokument i paraqitur në gjuhë të huaj duhet të jetë në gjuhën shqipe, ose i përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky që vlen për çdo dokument të paraqitur në këtë procedurë prokurimi. Sqarojmë se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës që paraqitet në këtë procedurë prokurimi. Në kushtet kur, në dokumentat e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në “Kriteret e Përgjithshme”, të cilat janë detyrimisht për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe detyrimisht për të mos u ndryshuar nga Autoriteti Kontraktor gjatë hartimit të dokumentave të tenderit, është përcaktuar qartë e saktë që “Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të liçensuar dhe të noterizuar në gjuhën shqipe”, atëherë i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer i noterizuar në gjuhën shqipe, përcaktim ky gjithpërfshirës që i përket çdo lloj dokumentacioni që do të paraqitet në këtë procedurë prokurimi nga operatorët

ekonomikë pjesëmarrës. Referuar seksionit II të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”. Sa më sipër dokumentacioni për këtë kontratë nuk është i rregullt dhe nuk mund të merret në konsideratë nga komisioni i vlerësimit të ofertave.

Pra operatori ekonomik “ikubINFO” shpk si pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk plotëson kriterin për paraqitje shërbime të ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkëpunim.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik "3i-solutions" shpk** me adresë: Rruga “Stavro Vinjau”, Pall 2, H.9, Zona Kadastrale Nr.8160, Tiranë, me një vlerë të përgjithshme prej **70.106.873 (shtatëdhjetë milion e njëqinde gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Tirana DC sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 16.03.2021.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Tirana DC sh.a, për procedurën e prokurimit me objekt **“Informatizimi i proceseve operacionale te shoqërisë Tirana DC sha, implementimi i infrastrukturës mbështetëse si dhe mirëmbajtja e tyre”** nuk është paraqitur asnjë ankesë.